



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.326/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Koalicija Vakati, me seli në Komuna Prizren, kundër Subjektit Politik Socialdemokratika Unija (SDU) me seli në Komuna Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 05.02.2025, mori këtë :

#### V E N D I M

**REFUZOHET** e pa bazuar ankesa e Subjektit Politik Koalicija Vakati, me seli në Komuna Prizren, Anr.326/2025, datë 03.02.2025, parashtruar kundër Subjektit Politik Socialdemokratika Unija (SDU) me seli në Komuna Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Koalicija Vakati, në të cilën pretendohet se Admir Aljilji, kandidat për deputet me numër rendor 3, në listën e Subjektit Politik Socialdemokratika Unija (SDU) 127, ka publikuar në mënyrë të paligjshme në rrjetin social Facebook, në grupin "skorobista info" dhe "lubizhda info", një provokim fyes nga një burim i njohur për atë, duke e mbuluar fotografinë e tij, e cila vërehet qartë.

Më tej në ankesë thuhet se ky publikim do të shkaktojë dëm dhe ofendim në llogarinë e kandidatit për deputet Qerim Bajrami, nga radhët e subjektit Politik Koalicioni Vakati, duke përhapur dezinformacione dhe urrejtje përmes burimeve të njohura për të, duke shkaktuar trazira tek qytetaret, votues potencial të koalicionit Vakati dhe kandidatit në fjalë.

Në ankesë ka bashkangjitur kopjet e postimeve të Admir Aljilit.

Mua pak më ka mashtrua Skorobishta au Lubizhda, Si dhe Grnçare e cila gjithherë shitet për pak të holla, kështu që këta dy deputetet tanë mjaft kanë arritur që këtë fshat ta mbërthejnë (me te holla)

Në përgjigjen në ankesë Anr.326/2025, të datës 03.02.2025, theksohet se në ankesën e bërë nga z. Çerim Bajrami kundër kandidatit Admir Aljili, konsiderojnë se në asnjë moment nuk e ka përmendur personin në njoftimin e tij, dhe as nuk e kanë ditur se bëhet fjalë për z. Çerim Bajrami, derisa kanë pranuar ankesën.

Mëj thuhet se z. Admir Aljili, nuk ka shkruar, por ka shpërndarë një foto që ka gjetur në grupe të tjera dhe e ka postuar në profilin e tij personal në Facebook, duke shprehur pakënaqësinë për përmbajtjen fyese të mesazhit drejtuar popullit dhe vendit nga vjen. Postimi i tij nuk përmbante akuza të drejtpërdrejta dhe as nuk i referohej një personi konkret në këtë rast, z. Çerima Bajrami por ishte një reagim ndaj përhapjes së përmbajtjeve të papërshtatshme që ofendojnë zotin Admir dhe komunitetin e tij nga Podgora.

Në përgjigje kanë bashkëngjitur prova- linçe të faqeve, si provë.

<https://www.facebook.com/share/19dNde5WSu/?mibextid=wwXlfr>

<https://www.facebook.com/share/1Ej6C9Jx4f/?mibextid=wwXlfr>

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli, pas shikimit të (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook të kandidatit për deputet nga radhët e Subjektit Politik Socialdemokratika Unija (SDU) Admir Aljilj, konstatohet se përdorimi i fotografisë të publikuar, nuk hynë në kategorinë e provave që nxisin urrejtje në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore, dhe Fotografia e përdorur nga kandidati Admir Aljilji nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një fotografie të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika l.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Paneli vlerësoi se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtresë i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura ligjore, dhe si të tilla këto pretendime i refuzoi si të pabazuar.


Në nenin 117.3 të LZP-së në mënyrë decisive thuhet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Anr. 326/2025 më datë 05.02.2025

**Kryesues i Panelit,  
Bujar Muzaqi**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.